



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 janar 2012
Nr. ref.: RK188/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 14/11

Parashtruesi

Baki Musa

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme Pzd.nr.
135/2010, të 21 janarit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi është z. Baki Musa me banim në Bërnice të Epërme, Komuna e Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Vendimin e Gjykatës Supreme Pzd. nr. 135/2010, të 21 janarit 2011, i cili iu dorëzua parashtruesit më 1 shkurt 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme shkel nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009 (nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli nr. 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 8 mars 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 mars 2011, Kryetari, me Urdhrin nr. GJR. 14/11 caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si Gjyqtar raportues. Në të njëjtën ditë, Kryetari, me Urdhrin nr. KSH. 14/11 caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Ivan Čukalovič.
7. Më 4 maj 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme.
8. Më 8 korrik, Gjykata kërkoi dokumentacion shtesë nga parashtruesi, i cili u përgjigj më 1 gusht 2011 dhe dorëzoi dokumentet e kërkuara.
9. Më 23 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 24 korrik 2001, Prokurori publik paraqiti akuzë në Gjykatën Komonale në Prishtinë kundër parashtruesit për kryerjen e veprës penale duke shkaktuar lëndime të rënda e të lehta trupore ndaj një pale të tretë.
11. Më 18 shkurt 2003, Gjykata Komonale e Prishtinës lëshoi një aktgjykim duke gjetur parashtruesin fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën ishte akuzuar dhe e dënoi atë me tetë muaj burgim (Aktgjykimi P. nr. 1643/2002). Parashtruesi u ankua për këtë aktgjykim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
12. Më 20 maj 2005, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komonale dhe dënoi parashtruesin me gjashtë muaj burgim (Aktgjykimi Ap. nr. 438/2003). Parashtruesi u ankua për këtë aktgjykim në Gjykatën Supreme.
13. Më 2 nëntor 2005, Gjykata Supreme e Kosovës anuloi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe e ktheu në Gjykatën e Qarkut për rigjykim (Aktgjykimi Pkl. nr. 34/2005). Gjykata Supreme konkludoi se vendimi i Gjykatës së Qarkut kishte shkelur nenin 403 (2) (1) të

Kodit të Procedurës Penale pasi që ankesa e Prokurorit publik nuk i ishte komunikuar parashtruesit.

14. Më 20 mars 2006, Gjykata e Qarkut rigjykoi rastin dhe lëshoi një aktgjykim duke dënuar parashtruesin me gjashtë muaj burgim (Aktgjykimi Ap. nr. 83/2006). Parashtruesi prapë u ankua për aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjykatën Supreme.
15. Më 15 janar 2009, Gjykata Supreme anuloi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe e ktheu për rigjykim (Aktgjykimi Pkl. nr. 1/2009). Gjykata Supreme prapë konkludoi se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut ishte duke shkelur nenin 403 (2)(1) të Kodit të Procedurës Penale, pasi ankesa e Prokurorit publik nuk i ishte komunikuar parashtruesit.
16. Si rezultat i kësaj, Gjykata e Qarkut ia përcjelli ankesën parashtruesit për komente. Më 2 dhjetor 2009, Gjykata e Qarkut vendosi të ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe të dënojë parashtruesin me gjashtë muaj burgim (Aktgjykimi Ap. nr. 68/2009). Përsëri parashtruesi u ankua kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme duke kërkuar zvogëlimin e dënimit.
17. Më 21 janar 2011, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për të zvogëluar dënimin. Gjykata Supreme konkludoi se nuk kishte rrethana të reja që arsyetojnë zvogëlimin e dënimit dhe që aktgjykimi i shqiptuar i Gjykatës së Qarkut ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj (Vendimi Pzd.nr. 135/2010).

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi pretendon se kishte shkelje të nenit 24 [Barazia Para Ligjit] dhe nenit 31 [e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, me arsyetimin se, meqenëse Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut kanë lëshuar një aktgjykim me gabime procedurale, ankesa e Prokurorit publik nuk i është komunikuar atij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 24 [Barazia Para Ligjit] dhe nenit 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, me arsyetimin se, meqenëse Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut kanë lëshuar një aktgjykim me gabime procedurale, ankesa e Prokurorit publik nuk i është komunikuar atij.
20. Megjithatë, në mënyrë që të gjykohet kërkesa e parashtruesit, është e nevojshme që së pari të shqyrtohet nëse parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë ashtu siç është specifikuar me Ligj dhe me Rregulloren e punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk mund të ankohet se gjykatat e rregullta kanë kryer gabime të fakteve ose ligjeve, përveç nëse ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë.
22. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e shkallës së katërt, kur merren parasysh vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjeve si procedurale edhe ato materiale (shih *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të drejtat e Njeriut [ECHR] 1999-I).

23. Gjykata mund vetëm të shqyrtojë nëse prova është paraqitur në mënyrë të tillë, dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar nga tërësia e tyre, janë kryer në mënyrë të atillë që parashtruesi ka pasur një gjykim të drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. nr. 13071/87 e aprovuar më 10 korrik 1991).
24. Sa i përket çështjes në fjalë, Gjykata vëren se Gjykata e Qarkut me Aktgjykimin Ap. nr. 68/2009, të 2 dhjetorit 2009, ka zbatuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme duke ia përcjellë ankesën e Prokurorit publik parashtruesit për komente. Për më tepër, Gjykata Supreme me vendimin Pzd. Nr. 135/2010, të 21 janarit 2011, përfundoi se nuk ka pasur rrethana të reja që arsyetojnë zvogëlimin e dënimit dhe se vendimi i shqiptuar nga Gjykata e Qarkut ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj.
25. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka treguar se në çfarë mënyre vendimi i Gjykatës Supreme ka qenë i padrejtë dhe i njollosur nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, Vendimi i KEDNJ sa i përket pranueshmërisë së kërkesës nr_17064/06, të 30 qershorit 2009 dhe Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i KEDNJ sa i përket pranueshmërisë së kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005) dhe si erdhi deri te shkelja e të drejtave kushtetuese të përmendura nga parashtruesi.
26. Në këto rrethana, kërkesa është qartazi e pabazuar sipas rregullit 36 (1. c) të Rregullores së punës që përcakton: "*Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa është qartazi e bazuar*".
27. Prandaj, kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet si e papranueshme

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhje me rregullin 36 (1. c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 nëntor 2011 njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË poshtë kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani